



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/09-54032 dt. 24/12/ 2025



Bazuar në nenin 11, 12, 40, 44, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 44, pika 3, të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 24.12.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për territorin e Komunës së Drenasit, 2026–2029

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Drenasit miratoj Planin për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për territorin e Komunës së Drenasit, 2026–2029.

Neni 2

Hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera e ka bërë Komisioni i caktuar me vendim të Kryetarit të Komunës, në përputhje me Planin Kombëtar për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera. Ky plan është hartuar brenda vitit fiskal dhe i njëjti paraqitet para Kuvendit për miratim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Bujupi

ARSYETIM

Pas skadimit të afatit të Planit të mëparshëm të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për territorin e Komunës së Drenasit, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, paraqitet nevoja për hartimin dhe miratimin e një plani të ri.

Ky Plan ka për qëllim identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve potenciale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe përcaktimin e masave parandaluese dhe mekanizmave të reagimit institucional. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka ky dokument për sigurinë e qytetarëve, mbrojtjen e pronës publike dhe private, si dhe funksionimin normal të shërbimeve komunale, kërkohet miratimi i tij nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

Miratimi i këtij Plani krijon bazën ligjore dhe institucionale për planifikim më të mirë, koordinim efektiv dhe reagim të shpejtë në rast të situatave emergjente në territorin e Komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/
Emergency Management Agency

Për:	z. Ramiz Lladrofc, Kryetar i Komunës së Drenasit; z. Bekim Lestrani, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Drenasit;	
Kopje:	z. Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së ; z. Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL-së; Njësia për Administrimin e Dokumenteve të MAPL-së	
Përmes:	z. Xhelal Sveçla, Ministër i MPB-së; z. Genc Metaj, Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së; z. Qëndrim Bytyqi, Drejtor i DL-së / MPB;	
Nga:	z. Shefki Abdullahu, UD Drejtor Ekzekutiv i AME-së;	
Zyrtarët përgjegjës:	z. Alush Beqiri, Drejtor i Departamentit të Parandalimit/ AME;	
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Nijazi Miftari, Udhëheqës i Divizionit për Vlerësim të Rreziqeve /Departamenti i Parandalimit;	
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Shqyrtim profesional të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Komuna e Drenasit (Glllogofcit)	
Lënda:	Shqyrtim profesional të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Komuna e Drenasit (Glllogofcit)	
Lloji i aktit:	☐ Statuti i komunës ☐ Rregullore komunale ☒ Vendim i Kuvendit të Komunës ☒ Akt tjetër i komunës: Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga FNFT	

Datë:
16.02.2026

I nderuar Kryetar Lladrofc,
I nderuar Kryesues Lestrani,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me nr. 04/-L-027, neni 44 paragrafi 3, kemi pranuar për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor të detyrueshëm draft-dokumentin e Vlerësimit të Rrezikshmërisë përmes Departamenti Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/-L -040 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Emri i aktit : Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga FNFT, Komuna e Drenasit, Nr. prot. 400/01-54032, datë: 28.12.2025
I miratuar më datë: 30.12.2025, nr. prot. VI-020-697;
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.01.2026, Nr. 020-697/2
I dërguar për shqyrtim në MPB /AME më datë: 12.01.2026 .

Ministria e Punëve të Brendshme, pas shqyrtimit profesional të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (FNFT) për Komunën e Drenasit **është në Pajtueshmëri me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Arsyetimi:

Ministria e Punëve të Brendshme/ Agjencia e Menaxhimit Emergjent, pas shqyrtimit profesional të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga FNFT, konkludon se ky dokument është në pajtueshmëri të plotë me kriteret e parapara sipas Rregullores nr, 25/2020 për Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga FNFT, neni 17, paragrafi 7.

Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera është bazë e mirë nga e cila mund të burojnë edhe projekte të shumta me qëllim të aplikimit të masave parandaluese dhe të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT për njerëzit, të mirat materiale, mjedisin dhe trashëgiminë kulturore.

Vlerësimi i Rrezikshmërisë për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera është dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent lokal, hartimit dhe ushtrimit të skenarëve, planeve zhvillimore komunale (PZhK) planeve hapësinore-zhvillimore si dhe planeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

(Shënim: Në shkresën e datës 02.02.2026 nr.prot 13/12 është bërë një lëshim teknik në faqen e parë të dokumentit ku është shënuar Komuna e Rahovecit në këtë dokument është përmirësuar dhe shënuar Komuna e Drenasit).

Me respekt!